

Shtatë tërmete janë regjistruara gjatë natës në rajonin e Pejës

Krijuar: Marte, 24 Shkurt 2015 13:37

Rrjeti sizmologjik i Kosovës ka regjistruar shtatë tërmete në rajonin e Pejës gjatë natës së kaluar. Pas tërmetit të parë që është ndjerë rreth orës 22:03 minuta i cili ka qenë 3.8 shkallë të Rihterit, të tjerët ishin të intensitetit më të ulët.

Shemsi Mustafa, udhëheqës i Rrjetit Sizmologjik të Kosovës i ka thënë TV 'Dukagjini'-t, se që nga tërmeti i parë që u regjistrua mbrëmë në orën 22:04 minuta e deri në orën 08:55 minuta të mëngjesit të sotëm, ky rrjet ka regjistruar 7 tërmete, por me intensitet më të ulët sesa i pari.

Ndërkohë sipas TV 'Dukagjinit', nuk raportohet për dëme të shkaktuara nga këto lëkundje në rajonin e Pejës.

Autoritetet lokale dhe rajonale nuk kanë të dhëna për dëme të regjistruara.